



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 90-të, të mbajtur më 04.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi sipas lëndës me numër 12-1143/1 të datës 20.02.2023, **NDËRPRITET.**

Sipas lëndës vepron PTHP-ja për ndjekje të krimit dhe korrupsionit të organizuar.

Lënda me numër 12-1143/1 të datës 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1143/1 datë 20.02.2023 është krijuar në bazë të raportit të auditimit të dorëzuar nr. /// nga Janari 2023 nga Enti Shtetëror i Revizionit të RMV-së. Në të konstatohen kushte që lindin dyshime për mos ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme nga zyrtarë në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore të RMV-së, me qëllim mbrojtjen e sistemit IT për të dhënat e personave të siguruar në RMV.

KSHPK-ja, duke vepruar në këtë rast, konstatoi se Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ka hapur lëndë për rastin konkret, për këtë arsye raporti i auditimit i lartpërmendur është dorëzuar në këtë prokurori. Rrjedhimisht, KSHPK-ja konsideron se nuk ka bazë për të ndërmarrë veprime të metutjeshme për çështjen konkrete, sepse një autoritet tjetër kompetent është duke vepruar sipas pretendimeve të gjetura në raportin e lartpërmendur të auditimit.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:
- Arkivi i RMV-së

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: K.N

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,**

Biljana Ivanovska

